

EPPC Albania për klientin e saj, kompani lider që operon në industrinë e produkteve promovionale, printime dixhitale dhe uniforma pune, po kërkon një **Përfaqësues i Marrëdhënieve të Biznesit**.

Përgjegjësitë kryesore:

- Analizimi i tregut dhe identifikimi i klientëve potenciale;
- Konvertimi i prospektëve në kliente të përsëritur;
- Planifikimi dhe ekzekutimi i planit të vizitave të klientëve në mënyrë të pavarur;
- Mirëmbajtja e marrëdhënieve me portofolin e klientëve që ka në ngarkim;
- Përgatitja e ofertave duke analizuar produktet dhe rekomandimet e duhura tek klientët, në varësi të nevojave të tyre;
- Bashkëpunimi me strukturat e tjera të kompanisë për realizimin final të porosive.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Të zotërojë aftësi të mira bindese dhe negociuese;
- Komunikim shumë i mirë dhe aftësi për të ndërtuar marrëdhënie biznesi;
- Disiplinë dhe aftësi për të punuar i pavarur;
- Aftësi për të punuar nën presionin e arritjes së rezultateve;
- Njohës i gjuhës angleze;
- Përdorim shumë të mirë të paketës Microsoft Office.
- **Aftësi drejtuese të mjetit, patentë Klasi B.**

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj në linkun që vijon:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.